



Mediatorsfederatie
KWALITEITSREGISTER *Nederland*

DOKUMENT PËR
POLITIKA PUBLIKE

.....

RRUGA E NDËRMJETËSIMIT NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT



DOKUMENT PËR
POLITIKA PUBLIKE

.....

RRUGA E NDËRMJETËSIMIT NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

Botues:
Instituti për politikë evropiane - Shkup

Përkthim nga gjuha angleze në gjuhën shqipe:
Blerina Starova Zlatku

Dizajn grafik:
Relativ
2022, Shkup



Kingdom of the Netherlands

Dokumenti i shkurtër është realizuar në kuadër të projektit “Ndërmjetësoni, mos dyshoni!”, të cilin Instituti për politikë evropiane (EPI) – Shkup e realizon në bashkëpunim me Akademinë e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë “Pavel Shat-ev”, Odën e Ndërmjetësuesve të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Federatën Holandeze të Ndërmjetësuesve. Projekti financohet nga Ambasada e Mbretërisë së Holandës në Shkup.



Përmbajtja

- 4 Konteksti
- 5 Analiza e aplikimit të ndërmjetësimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut
- 6 Ndërmjetësimi në çështjet civile
- 7 Ndërmjetësimi në çështjet penale
- 9 Rruga e ndërmjetësimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut
- 10 Të dhëna rreth ndërmjetësimit nga Ministria e Drejtësisë
- 11 Perceptimi i ndërmjetësimit të sektorit privat në Republikën e Maqedonisë së Veriut
- 12 Risi në ligj
- 14 Konkluzion



Konteksti

Ndërmjetësimi si mënyrë alternative për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve për herë të parë në Republikën e Maqedonisë së Veriut u paraqit me Ligjin për Ndërmjetësim nga viti 2006, pas të cilit në vitin 2013 u miratua ligji i ri, i cili u pasua nga Ligji aktual për Ndërmjetësim (në tekstin e mëtejme: Ligji), i cili u miratua nga Kuvendi në dhjetor 2021.¹

Qëllimi i miratimit të ligjit të ri ishte trajtimi i reformave në lidhje me ndërmjetësimin, si një nga objektivat strategjike të Strategjisë për Reformën në Sektorin e Drejtësisë 2017-2022.²

Megjithatë, me gjithë miratimin e zgjidhjes së re ligjore dhe risitë e sjella me të, avantazhet e mundshme që sjell ndërmjetësimi nuk shfrytëzohen plotësisht nga qytetarët.

1 Ligji për Ndërmjetësimin, ("Gazeta Zyrtare" Nr. 294/2021, datë 27.12.2021)

2 Strategjia për reformën e sektorit të drejtësisë për periudhën 2017-2022 me plan veprimi, Ministria e Drejtësisë, (Стратегија за реформа на правосудниот сектор за периодот 2017-2022 година со акциски план, Министерство за правда.) https://www.pravda.gov.mk/Upload/Documents/Strategjia%20i%20akciski%20plan_MK-web.pdf



Analiza e aplikimit të ndërmjetësimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut³

Arsyet për aplikimin e pamjaftueshëm të konceptit të ndërmjetësimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë diskutuar në detaje në *Analizën e aplikimit të ndërmjetësimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut e përgatitur në kuadër të projektit “Ndërmjetësoni, mos hezitoni”⁴*, i cili është zbatuar nga Instituti i Politikave Evropiane (EPI) - Shkup në bashkëpunim me Akademinë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë “Pavel Shatev”, Odën e Ndërmjetësuesve të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Federatën Holandeze të Ndërmjetësuesve, e cila financohet nga Ambasada e Mbretërisë së Holandës në Shkup.

Analiza është e ndarë në dy pjesë: (1) analiza teorike e ndërmjetësimit, zgjidhjet ligjore për ndërmjetësimin dhe legjislacioni përkatës nga fusha civile dhe penale dhe legjislacioni për fëmijët; dhe (2) analiza sasiore e aplikimit të ndërmjetësimit në praktikë nga të gjitha palët relevante të interesit – gjykatat, prokuroria, ndërmjetësuesit, sektori privat.

³ Llazhetiq, Gordana, Koshevaliska, Olga dhe Nanev, Lazar (2022). Analiza e aplikimit të ndërmjetësimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Instituti për Politikë Evropiane - Shkup

⁴ <https://epi.org.mk/post/15674>

NDËRMJETËSIMI NË ÇËSHTJET CIVILE

Ndërmjetësimi mund të përdoret në një numër të madh të llojeve të ndryshme të kontesteve civile⁵, dhe sipas Ligjit për procedurën civile në mosmarrëveshjet tregtare për kërkesat në të holla deri në 1.000.000 denarë, palët janë të obliguara që kontestin ta zgjidhin me ndërmjetësim.⁶ Megjithatë, gjyqtarët kanë një mendim të ndarë nëse futja e një përpjekjeje të detyrueshme për ndërmjetësim në këto konteste kontribuon në një përdorim më të madh të ndërmjetësimit dhe hulumtimi tregoi se shumica e tyre nuk janë pro rritjes së këtij limiti ligjor maksimal.

Nga ana tjetër, përqindja e palëve që kërkojnë informacion nga gjyqtarët për ndërmjetësimin është jashtëzakonisht e vogël (18%), por 39% e gjyqtarëve besojnë se do të ishte e dobishme të kishte një detyrim ligjor për t'i referuar palët në një tentativë të detyrueshme për ndërmjetësim në kontestet e ndërmjetësueshme. Arsyet e përfaqësimit të dobët të ndërmjetësimit gjyqtarët i shohin në interesin e dobët të palëve (35%), por edhe faktin se palët nuk e njohin mjaftueshëm ndërmjetësimin (25%).

Sipas përvojës dhe njohurive të tyre për çështjen, gjyqtarët e departamenteve civile si arsye kryesore të dështimit të ndërmjetësimit e shohin tërheqjen e palëve gjatë procedurës së ndërmjetësimit dhe deklaratën me shkrim të ndërmjetësit se tentativat e mëtejshme për ndërmjetësim nuk justifikohen. Shumica e gjyqtarëve janë pro vendosjes së një tentative të detyrueshme ndërmjetësimi kur bankat, shoqëritë financiare dhe shoqëritë e sigurimit, por edhe autoritetet shtetërore, institucionet dhe ndërmarrjet publike në pronësi shtetërore dhe NJVL-të janë palë në kontest, gjë që, në një farë mënyre, reflekton besimin gjyqësor në ndërmjetësimin. Gjithashtu, në një përqindje të konsiderueshme të gjyqtarëve, do të ishte e dobishme të parashikohej mundësia e një tentative të detyrueshme ndërmjetësimi në rastin e një divorci miqësor. Por ka edhe një numër shumë të vogël gjyqtarësh që nuk pajtohen për zgjerimin e bazave ligjore për përpjekje të detyrueshme për ndërmjetësim për të gjitha çështjet e përmendura më parë.

Pikëpamjet më të zakonshme që mbizotërojnë në mesin e gjyqtarëve që gjykojnë në çështjet civile në lidhje me ndërmjetësimin janë se ndërmjetësimi është një mekanizëm i dobishëm dhe një procedurë reale për zgjidhjen e kontesteve (31%), si dhe se ndërmjetësimi është një përpjekje e mirë e shtetit pa arritje të rëndësishme deri më tani (30%). 16% konsiderojnë se ndërmjetësimi nuk është një projekt mjaft mirë i menduar. Si anë negative të ndërmjetësimit, sipas gjyqtarëve që gjykojnë në çështjet civile, gjyqtarët veçojnë më së shumti: mosbesimin e palëve në ndërmjetësim, shqyrtimin e pamjaftueshëm ligjor të procedurës së ndërmjetësimit dhe ndërmjetësit nuk kanë autoritet tek qytetarët.

Për sa i përket **propozimeve** që gjyqtarët që gjykojnë në çështjet civile japin për përmirësimin e zbatimit të ndërmjetësimit, veçojmë: promovimi i avantazheve të procedurës së ndërmjetësimit, krijimi i kushteve më të favorshme në lidhje me procedurën gjyqësore, mbajtja e seminareve dhe

5 Ndërmjetësimi si mënyrë e zgjidhjes së kontesteve përmendet në Ligjin për ndihmë juridike falas, Ligjin për procedurën civile, Ligjin për procedurën penale, Ligjin për drejtësinë për fëmijët, Ligjin për organizmat e modifikuar gjenetikisht, Ligjin për ofrimin e shërbimeve financiare në distancë, Ligji për mbrojtjen e konsumatorit, Ligji për mbrojtjen nga zhurma në mjedis, Ligji për inspektoratin shtetëror të tregut, Ligji për mjedisin jetësor, Ligji për cilësinë e ajrit të ambientit, Ligji për zgjidhjen paqësore të mosmarrëveshjeve të punës, Ligji për Mbrojtjen Sociale, Ligji për Shoqëritë Tregtare, në kontratat kolektive në fushën e arsimit etj.

6 Neni 461 i Ligjit për Procedurën Civile.

takimeve të punës për të evidentuar mangësitë, ndërmjetësimi të kryhet në gjykatë në prani të ndërmjetësuesit dhe gjyqtarit me përvojë në atë lloj çështjeje, për t'iu treguar palëve shanset e suksesit, praktikën gjyqësore, kostot, etj., kosto më të ulëta dhe besim më të lartë mes palëve, ndërmjetësuesit t'i njohin ligjet, të jenë më të hapur ndaj publikut dhe të mos udhëhiqen nga interesat personale, zgjidhje më të mira ligjore, ndërmjetësimi të bëhet nga një gjyqtar në rolin e një ndërmjetësues, më shumë trajnim të ndërmjetësuesve, uljen e shpenzimeve për ndërmjetësim, të miratohet ndihmë ligjore falas, inkuadrimi i gjyqtarëve me më shumë përvojë, inkuadrimi i gjyqtarëve të pensionuar për të krijuar besim tek qytetarët, promovimi i ndërmjetësimit përmes forumeve publike, duke përfshirë publikun, edukimin e palëve rreth ndërmjetësimit.

NDËRMJETËSIMI NË ÇËSHTJET PENALE

Në bazë të dispozitave të Ligjit të Procedurës Penale,⁷ në rastet kur krimi ndiqet me padi penale private, gjyqtari kompetent në seancën e pajtimit për arsye të përshtatshmërisë mund t'u bëjë propozim palëve që të japin pëlqimin për referim në ndërmjetësim. Pas pëlqimit të palëve, gjyqtari individual merr vendim për dërgimin e palëve në ndërmjetësim. Nëse palët nuk japin pëlqimin brenda afatit të caktuar, gjyqtari individual vendos që propozimi për referim në ndërmjetësim nuk pranohet dhe cakton seancën kryesore sipas dispozitave për procedurën e shkurtuar. Brenda tri ditëve nga dhënia e pëlqimit, palët do të përcaktojnë me pajtim një ose më shumë ndërmjetës nga Drejtoria e ndërmjetësuesve dhe do të njoftojnë gjyqtarin individual në përputhje me rrethanat.

Për sa i përket ndërmjetësimit në çështjet penale, 56% e gjyqtarëve të anketuar mendojnë se ndërmjetësimi në padi private nuk jep rezultate pozitive, ndërsa vetëm 13% e gjyqtarëve të anketuar mendojnë të kundërtën. Në 5 vitet e fundit, 75% e këtyre gjyqtarëve nuk kanë aplikuar asnjëherë procedurën e ndërmjetësimit dhe 89% e tyre kanë deklaruar se palët asnjëherë nuk u kanë kërkuar informacion për ndërmjetësimin.

Procedura e ndërmjetësimit për fëmijët rregullohet nga dispozitat e Ligjit për Drejtësi për Fëmijët⁸, në të cilin zgjidhjet ligjore të parashikuara në procedurën kundër autorëve të rritur të krimeve janë përshtatur me legjisllacionin për fëmijët, si dhe referohen edhe tek Ligji. Ligji për drejtësinë për fëmijët rregullon kushtet në të cilat mund të kryhet ndërmjetësimi, mënyrën e përcaktimit të ndërmjetësit, kushtet që duhet të plotësohen në mënyrë që një person të veprojë si ndërmjetës në procedurën për fëmijën, kohëzgjatjen e procedurës të ndërmjetësimit, rrjedhjen e saj dhe mënyrat se si mund të përfundojë procedura e ndërmjetësimit. Qëllimi kryesor i ndërmjetësimit për fëmijët është një dialog që do t'i mundësojë fëmijës të kuptojë se çfarë ka bërë, të kuptojë pozicionin e viktimës gjatë krimit dhe pas tij, të dëgjojë vuajtjet e viktimës dhe pasojat që ka pësuar.⁹

7 Kreu 30, Ligji për Procedurën Penale, ("Gazeta Zyrtare" Nr. 150, datë 18.11.2010).

8 Ligji për Drejtësinë për Fëmijët ("Gazeta Zyrtare" Nr. 148/2013).

9 Lazetic, Gordana, Koshevaliska, Olga dhe Nanev, Lazar (2016). Drejtësi restauruese ndaj fëmijëve (Ресторативна правда спрема деца.). Revista maqedonase e së drejtës penale dhe kriminologjisë, 1 (1), fq. (Македонска ревија за кривично право и криминологија, 1 (1), pp) 1-24.

Nga gjyqtarët që gjykojnë në procedurën ndaj fëmijëve, 45% mendojnë se ndërmjetësimi në procedurën ndaj fëmijëve do të jepte rezultate pozitive, ndërsa 35% kanë qëndrim negativ për këtë çështje. 75% e gjyqtarëve të anketuar nuk i kanë referuar palët në procedurë ndërmjetësimi në pesë vitet e fundit, 20% e të anketuarve kanë pasur raste kur i kanë referuar palët në procedurë ndërmjetësimi. Për arsyet e dështimit të ndërmjetësimit në çështjet penale ndaj fëmijëve, më shumë se gjysma e gjyqtarëve të pyetur nuk kanë dhënë përgjigje dhe gjyqtarët që i janë përgjigjur kësaj pyetje kanë përmendur ose skadimin e afatit 45-ditor ose tërheqjen e palëve si arsye.

Përveç gjyqtarëve, në këtë fokus grup ishin edhe prokurorët, nga të cilët 35% deklaruan se i dërguan palët në ndërmjetësim.

Në përgjithësi, gjyqtarët në çështjet penale për të rritur, gjyqtarët për fëmijë, si dhe prokurorët publikë bien dakord për arsyet e mëposhtme më të zakonshme për përfaqësimin e ulët të ndërmjetësimit në praktikën gjyqësore: mungesa e interesit nga palët, ndërgjegjësimi i pamjaftueshëm për ndërmjetësimin dhe promovimi i pamjaftueshëm për avantazhet e ndërmjetësimit në publik.

Si **rekomandime** për përmirësimin e ndërmjetësimit, gjyqtarët që gjykojnë në lëndët penale shprehen si në vijim: promovim më i madh i avantazheve të procedurës së ndërmjetësimit; në rastin e padive private, pasi të jenë pranuar në gjykatë, ato duhet t'i paraqiten ndërmjetësit të autorizuar dhe t'i kthehen gjykatës pas kryerjes së procedurës, përkatësisht pasi të jetë bërë një përpjekje për ndërmjetësim ose të dëshkohet se ndërmjetësimi ishte i pasuksesshëm; procedura e ndërmjetësimit duhet të jetë më e aksesueshme dhe e dizajnuar më mirë; ndërmjetësit të jenë më të hapur ndaj publikut, të njohin ligjet në mënyrë që të ndihmojnë me sukses palët dhe të mos udhëhiqen nga interesat personale; ndryshimet ligjore, fushata për debat publik përpara se të fillojë çdo ndryshim ligjor, fushata për afirmimin e ndërmjetësimit si procedurë, duke afirmuar anët pozitive të ndërmjetësimit, në ekipet për ndryshime ligjore të dëgjohen pikëpamjet e praktikuesve - atyre që përballen me problemet e përditshme; transparencë më e madhe përmes njohjes me mbulimin mediatik; edukimin e avokatëve për të këshilluar palët për procedurën e ndërmjetësimit.

Rekomandimet nga gjyqtarët për fëmijët, me qëllim të përmirësimit të aplikimit të ndërmjetësimit, janë: Detyrimisht të kryhet një procedurë ndërmjetësimi përpara paraqitjes së kërkesës për procedurë përgatitore para gjyqtarit për fëmijë; ndërgjegjësim më i madh i palëve për procedurën e ndërmjetësimit; motivimi i ndërmjetësuesve duke subvencionuar pjesën më të madhe të shpenzimeve përmes Ministrisë së Drejtësisë; më shumë edukim të palëve, diskutime dhe debate të hapura.

Propozimet të Prokurorisë Publike për përmirësimin e aplikimit të ndërmjetësimit janë: ndërgjegjësim më i madh për ndërmjetësimin, më shumë trajnime për këtë temë, procedura për fëmijët është e natyrës urgjente, prandaj ndërmjetësimi përdoret më rrallë (zakonisht zgjat procedura), kështu që gjithçka shkon sipas procedurës së zakonshme; nga ana e Ministrisë së Punëve të Brendshme me rastin e paraqitjes së kallëzimit penal duhet të dorëzohen raporte të veçanta që do të përmbajnë më shumë informacion për rrethanat në të cilat është kryer krimi dhe për disponimin e palëve për të arritur marrëveshje në mënyrë që të mos zhvillohet procedura penale; të shkurtojë kohëzgjatjen e procedurës së ndërmjetësimit nga 45 ditë në 30 ditë; gjetja

e mekanizmave për ndërgjegjësimin më të madh të qytetarëve, gjegjësisht që publiku të dijë për mundësinë e zgjidhjes së çështjeve me ndërmjetësim, dhe veçanërisht të informohen për efektet pozitive të zgjidhjes së rasteve penale ndaj fëmijëve me ndërmjetësim, veçanërisht shmangia e viktimizimit të fëmijëve duke shkuar në institucionet përgjegjëse për trajtimin e kallëzimeve penale dhe shmangia e ekzistimit të dosjeve penale për autorët fëmijë të krimeve; për të trajnuar ndërmjetës që do të punonin ekskluzivisht në procedimet penale për fëmijët; kostot e procedurës së ndërmjetësimit duhet të mbulohen tërësisht nga buxheti.

RRUGA E NDËRMJETËSIMIT NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

Shumica e të intervistuarve/ndërmjetësuesve mendojnë se futja e një tentative të detyrueshme për ndërmjetësim në mosmarrëveshjet e biznesit ka dhënë rezultate pozitive dhe sipas të dhënave të tyre, në 25% të rasteve ndërmjetësimi ka qenë i suksesshëm. Konteste më të zakonshme për ndërmjetësim janë kontestet e punës dhe ekonomike, palët zakonisht kërkojnë informacion nga vetë ndërmjetësit dhe vendosin për ndërmjetësim ose avokatët e tyre i këshillojnë për të, dhe nga ana tjetër, më së shpeshti i pandehuri/i akuzuari nuk pajtohet me propozimin për ndërmjetësim. Si arsye për përfaqësimin e dobët të ndërmjetësimit në praktikën gjyqësore, ata përmendin njohjen e pamjaftueshme me ndërmjetësimin - 33%, 27% e ndërmjetësuesve e shohin si problem promovimin e pamjaftueshëm të avantazheve të ndërmjetësimit në publik, ndërsa 18% besojnë se avokatët shpesh këshillojnë klientët të mos pranojnë ndërmjetësimin.

Ndërmjetësit theksuan problemet/pengesat e mëposhtme që hasin në zbatimin e procedurës: hapësira për mbajtjen e ndërmjetësimit; përfshirjen e pamjaftueshme të palëve në procedurën e ndërmjetësimit; mosinteresimi i palëve për të përfunduar një marrëveshje; vështirësi në mbledhjen e tarifave; subvencione të papaguara përkundër plotësimit të të gjitha kushteve të përshkruara, etj.

Për aplikim më të madh të ndërmjetësimit, ndërmjetësuesit **sugjerojnë**: promovimin më të madh të ndërmjetësimit dhe informimin e publikut për avantazhet e procedurës së ndërmjetësimit; angazhim më i madh i gjyqtarëve dhe prokurorive publike për zbatimin e ndërmjetësimit; trajnimi i përhershëm i ndërmjetësuesve dhe përmirësimi i vazhdueshëm i tyre, i cili do të kontribuojë në menaxhimin më të mirë të procedurave; mbajtja e një tarife për kostot në procedurën e ndërmjetësimit; kontrollimi i numrit të rasteve me tentativë të detyrueshme ndërmjetësimi (çështjet tregtare) që janë pranuar në gjykatë dhe nuk janë ndërmjetësuar më parë; përkujtim zyrtar për autoritetet shtetërore për Konkluzionin e Qeverisë për aplikimin e ndërmjetësimit – autoriteteve shtetërore duhet t'u kërkohet të iniciojnë procedurën e ndërmjetësimit ekskluzivisht përmes Odës së Ndërmjetësuesve para fillimit të procedurave gjyqësore; ndërmjetësimi duhet të gjejë vend në kontestet me vlerë të vogël, veçanërisht për shpenzimet e përgjithshme (rrymë, ujë, ngrohje, telefon, etj.), si dhe për procedurat e divorcit kur palët duan ta bëjnë këtë në mënyrë miqësore; krijimi i një qendre ndërmjetësimi me mjediset dhe organet e veta që do të kujdeset për promovimin e ndërmjetësimit, mbështetjen e ndërmjetësve në aspektin e burimeve - një ambient

për kryerjen e ndërmjetësimit, ambient për seminare dhe trajnime, pajisje teknike, ndihmë ligjore dhe të tjera profesionale, etj.; miratimi i ndryshimeve ligjore për aplikim më të madh të ndërmjetësimit në sistemin e drejtësisë për fëmijët dhe mosmarrëveshjet familjare e martesore; vula e ndërmjetësit të ketë fuqinë e ekzekutimit të Marrëveshjes; detyrimi i ndërmjetësimit në urdhërpagesat; vendosja e një takimi të detyrueshëm me një ndërmjetës, përpara fillimit të procesit gjyqësor, për t'u dhënë palëve mundësinë për të sqaruar mosmarrëveshjen.

TË DHËNA RRETH NDËRMJETËSIMIT NGA MINISTRIA E DREJTËSISË

Në analizë u mblodhën edhe të dhëna për ndërmjetësimin nga Ministria e Drejtësisë, nga ku mund të konstatohet se të dhënat për aplikimin e ndërmjetësimit në e-regjistrin nuk janë futur në përputhje me pritshmërinë e planifikuar, për faktin se nuk ka pasur detyrim ligjor për këtë, gjë që u korrigjua me ligjin e ri. Të dhënat në e-regjistrin ende po përditësohen dhe mundësia e futjes së të dhënave për vitet e mëparshme është e hapur.

Nga të dhënat e marra nga Ministria e Drejtësisë, del qartë se aplikimi modest i ndërmjetësimit në procedurën për fëmijët është në fillimet e tij dhe kur zbatohet, përfundon me sukses me marrëveshje. Në lidhje me rastet e regjistruara në regjistrin elektronik për ndërmjetësim në periudhën **prej 2016 deri në vitin 2021 janë lidhur gjithsej 2511 marrëveshje, nga të cilat 1377 ose 55% aplikim i suksesshëm i ndërmjetësimit**, që është për t'u përshëndetur. Më shpesh, kontestet e punës përfundohen me sukses, ku përqindja e suksesit është e lartë 91%, dhe e dyta për nga zbatimi janë kontestet ekonomike, ku përqindja e suksesit është 18%.

PERCEPTIMI I NDËRMJETËSIMIT TË SEKTORIT PRIVAT NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

Për qëllime të analizës është mbajtur edhe një fokus grup me përfaqësues nga sektori privat, konkretisht nga Oda Ekonomike e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Lidhja e Odave Ekonomike të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Konfederata e Biznesit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, të cilët dhanë një kontribut të veçantë në këtë hulumtim, duke përfaqësuar interesin dhe pikëpamjet e anëtarëve të tyre dhe komunitetit të biznesit.

Në lidhje me opinionin e fokus grupit dhe në lidhje me rezultatet e pritura pozitive nga futja e një tentative të detyrueshme për procedurën e ndërmjetësimit në rastet sipas nenit 461 të K.Pr.Civile (për mosmarrëveshjet ekonomike që i referohen kërkesave monetare deri në 1.000.000 denarë), përfaqësuesit e odave ekonomike në vend konsiderojnë se tentativa e detyrueshme nuk ka kontribuar në aplikimin aktual të ndërmjetësimit, por vetëm në aplikimin e tij formal. Futja e një tentative të detyrueshme nuk mund të jetë një zgjidhje e përhershme, por vetëm një zgjidhje e përkohshme për stimulim, qëllimi i së cilës ishte njohja e subjekteve me ndërmjetësimin dhe përfitimet e tij, në mënyrë që ata ta zbatonin me iniciativën e tyre në të ardhmen. Numri i tentativave në këtë

pjesë është rritur, por ky numër, sipas tyre, nuk kontribuon në suksesin e ndërmjetësimit, sepse numri nuk jep një pasqyrë reale të aplikimit të tij, gjë që shihet nga përqindja e ndërmjetësimeve të kryera me sukses në tentativën e detyrueshme. Ata janë unanim që kompanitë refuzojnë diçka që është e detyrueshme, e shohin si një barrë shtesë financiare, ndaj gjejnë mënyra për të shmangur tentativën e detyrueshme. Në këtë po kërkojnë edhe arsyen e tentativave të dështuara të ndërmjetësimit. Ata janë të mendimit se palët i qasen detyrimit me një dozë të madhe skepticizmi dhe nuk tentojnë fare ndërmjetësimin. Natyra e detyrueshme është arsyeja për numrin e lartë të lëndëve, por edhe e shkallës së lartë të dështimit në këto lëndë. Shkalla e suksesit të ndërmjetësimit është 99% në mosmarrëveshjet e punës, sepse aty palët kanë dalë vullnetarisht, kanë ndërmarrë veprime, kanë dhënë mundësi për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me ndërmjetësim dhe kanë parë që mosmarrëveshja mund të zgjidhet pa filluar procedura gjyqësore.

Rekomandimet për përmirësimin dhe avancimin e zgjidhjeve të ndërmjetësimit nga komuniteti i biznesit janë si më poshtë: promovim më i mirë që do të zbatohet në mënyrë efikase midis të gjithë aktorëve dhe do të rrisë ndërgjegjësimin e të gjithëve; konsultimi i opinionit të komunitetit të biznesit lidhur me miratimin e zgjidhjeve të reja ligjore, por edhe për zbatimin e zgjidhjeve ekzistuese ligjore për ndërmjetësim; përmes mediave dhe institucioneve amë të ketë konferenca dhe aktivitete për promovim; zberthimi i temave tabu për ndërmjetësim; më shumë projekte të përbashkëta ndërmjetësimi; shqyrtimi i avantazheve të ndërmjetësimit në procedurat e falimentimit dhe më shumë aktivitete në këtë fushë; përmirësimi i aplikimit të ndërmjetësimit në mosmarrëveshjet konsumatore; strategji e sinkronizuar për promovimin e ndërmjetësimit; ndërmjetësim pilot (falas) në sektorin e ndërtimit; prodhimin e kërkimeve dhe analizave ndërmjetësuese që do të ofrojnë drejtim në fushat që kërkojnë ndërhyrje; duke marrë parasysh perspektivat për ndërmjetësimin online.



Risi në ligj

Si fillim, është e nevojshme të theksohet se Ligji ndjek direktivën 2008/52/KE për ndërmjetësimin në mosmarrëveshjet civile dhe tregtare¹⁰ dhe Mjetet e Zhvillimit të Ndërmjetësimit CEPEJ të vitit 2018¹¹, e cila e afron Republikën e Maqedonisë së Veriut me standardet evropiane për ndërmjetësim. Mbështetja për zhvillimin e ndërmjetësimit vjen përmes masave dhe mjeteve të parapara me programin për zhvillimin e ndërmjetësimit të realizuar nga Qeveria për një periudhë të paktën katër vjeçare, si dhe me programin e posaçëm për mbështetjen e ndërmjetësimit të kryer nga Këshilli Gjyqësor (me ligjin e ri, Gjykata e Lartë nuk i nënshtrohet më një detyrimi të tillë). Përveç kësaj, si nxitje për qytetarët, si edhe më parë, shteti subvencionon një pjesë të shpenzimeve të bëra në procedurën e ndërmjetësimit ndërmjet palëve të njëjta për një marrëdhënie kontestuese, por ligji i ri ka vendosur një kufi monetar: jo më shumë se 4.000.00 për rast nga lista e bashkëngjitur e tarifave të ndërmjetësit. Përparësi tjetër për qytetarët është zgjidhja e shpejtë e kontesteve të zgjidhura me ndërmjetësim në krahasim me rastet gjyqësore – procedura duhet të përfundojë brenda 90 ditëve, ndërsa sipas Ligjit për drejtësi për fëmijët, ndërmjetësimi është paraparë të përfundojë brenda 45 ditëve.

10 Direktiva 2008/52/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 21 majit 2008 për disa aspekte të ndërmjetësimin në çështjet civile dhe tregtare, CELEX 32008L0052, OJ L 136, 24.5.2008, f. 3-8

11 Mediation Development Toolkit, European Commission for the efficiency of justice (CEPEJ), CEPEJ(2018)7REV, <https://rm.coe.int/mediation-development-toolkit-ensuring-implementation-of-the-cepej-gui/16808c3f52>

Një risi tjetër shumë e rëndësishme në ligj është zgjerimi i fushëveprimit të kontesteve të ndërmjetësuar - konkretisht, tani ndërmjetësimi mund të zbatohet edhe për kontestet që dalin nga procedurat e urdhërpagesave noteriale, kontestet në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë, kontestet në fushën e mbrojtjes shëndetësore dhe mosmarrëveshjet lidhur me përgjegjësinë civile për fyerje dhe shpifje.

Objektivat për të cilat është miratuar ligji janë arritur përmes: rishikimit të mënyrës së dhënies së provimit për ndërmjetës, futjes së mundësisë së fillimit të procedurës së ndërmjetësimit në mënyrë elektronike dhe futjes së detyrueshme të regjistrimit të të gjitha kërkesave të pranuar për ndërmjetësim në Regjistrin Elektronik dhe regjistrimit të detyrueshëm të të dhëna për ecurinë e mëtejshme të procedurës. Krahas këtyre risive, ligji vendos një Këshill Kombëtar për Ndërmjetësim dhe rregullon më nga afër funksionimin dhe përgjegjësitë e tij, i cili do të përbëhet nga një Koordinator Kombëtar i Ndërmjetësimit, katër anëtarë dhe një sekretar. Këshilli ka buxhetin e tij dhe parashikohen kriteret që duhet të plotësojnë koordinatori kombëtar dhe anëtarët për t'u zgjedhur nga Qeveria. Në seancën e 54-të të Qeverisë, nënkryetarja e Odës Ekonomike të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe kryetare e Shoqatës së Ndërmjetësimit pranë Odës, Dr. Jelisaveta Georgieva Jovevska, u emërua Koordinatorja e parë Nacionale për Ndërmjetësim.¹²

Në prill të vitit 2022, në bazë të ligjit, janë miratuar dhe publikuar aktet nënligjore si në vijim:

- Rregullore për kriteret më të detajuara, mënyrën e subvencionimit, pagesën, formularin për shpërblimin e arkëtuar, shpenzimet e ndërmjetësuesit, formularin e kërkesës për subvencionim dhe dokumentacionin e nevojshëm që dorëzohet krahas kërkesës për subvencionimin e një pjese të shpenzimeve të ndërmjetësimit;¹³
- Rregullore për mënyrën e mbikëqyrjes së punës së Odës së ndërmjetësuesve të Republikës së Maqedonisë së Veriut;¹⁴
- Rregullore për përmbajtjen e Regjistrit të kërkesave të pranuar për ndërmjetësim dhe mënyrën e regjistrimit të kërkesave të pranuar për ndërmjetësim;¹⁵ dhe
- Rregullore për Programin për dhënien e provimit për ndërmjetës, mënyrën e organizimit dhe dhënies së provimit, mënyrën e zhvillimit të provimit, si dhe formën dhe përmbajtjen e certifikatës së dhënies së provimit.¹⁶

Pritet që në periudhën e ardhshme të zbatohet në mënyrë konsekuente Ligji, të kryhet një procedurë për emërimin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Ndërmjetësimit (për të cilin aktualisht është hapur një Njoftim Publik për shprehjen e interesit për pjesëmarrje në Këshillin Kombëtar të Ndërmjetësimit, me afat për aplikimet deri më 5 gusht)¹⁷, si dhe të miratohen akte të tjera nënligjore të parashikuara në bazë të këtij ligji.

12 Dr. Jelisaveta Georgieva Jovevska e emëruar nga Qeveria si Koordinatorja Nacionale për Ndërmjetësim, korrik 2022, <https://www.mchamber.mk/Default.aspx?mld=3&lng=1&evld=90305>

13 ("Gazeta Zyrtare" Nr. 91/2022, datë 12.04.2022)

14 ("Gazeta Zyrtare" Nr. 100/2022, datë 26.04.2022)

15 ("Gazeta Zyrtare" Nr. 100/2022, datë 26.04.2022)

16 ("Gazeta Zyrtare" Nr. 101/2022, datë 27.04.2022)

17 Njoftim publik për shprehje të interesit për pjesëmarrje në Këshillin Nacional për Ndërmjetësim, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, 20.07.2022, <https://mada.mk/node/29660>



Konkluzion

Përveç mungesës së vetëdijes dhe vullnetit të qytetarëve për të aplikuar ndërmjetësimin para fillimit të procedurës gjyqësore dhe ndjenjës së skepticizmit në mesin e gjyqtarëve, prokurorëve publikë dhe sektorit privat, nuk mund të mohohet se ndërmjetësimi ka përparësi të konsiderueshme ndaj procedurave gjyqësore.

Ndërmjetësimi është një procedurë vullnetare, e barabartë, neutrale, informale, konfidenciale, jopublike, e shpejtë dhe ekonomike. Për shkak të këtyre karakteristikave, ai duhet të promovohet me synim aplikimin më të shpeshtë dhe më efikas, si nga autoritetet shtetërore, ashtu edhe nga përfaqësues të sektorit joqeveritar dhe përfaqësues të Dhomës së Ndërmjetësuesve.

